



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 64, datë 24. 12. 2021

“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE 2022”


Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24. 12. 2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 9632, datë 30. 10. 2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligji Nr.68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

VENDOSI:

1. Miratimin e paketës fiskale 2022, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 14 vota pro , votë kundër – s’ka, 1- votë abstenim .

Për zbatimin e këtij vendimi Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI